

**AKT I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“JONIAN HEAVEN GROUP” SH.P.K.**


Sot, në datën 30/01/2019, në qytetin e Tiranës, personat e mëposhtëm, mbliidhen dhe bien dakord të themelojnë Shoqërinë “**Jonian Heaven Group**” Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duke nënshkruar këtë Akt Themelimi dhe Statut në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë.

- 1) **Z. ARBEN TAIPI**, shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 01.04.1965 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033599348 dhe me numër personal G50401087C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- 2) **Z. INDRIT BAKALLI** shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 02.10.1976 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028471486 dhe me numër personal H61002094F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 3) **Z. ELTON POGA** shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 07.06.1976 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024402998 dhe me numër personal H60607061B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- 4) **Z. BESNIK MYFTARI** shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 14.06.1968 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030031481 dhe me numër personal G80414170N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- 5) **Z. ARTAN LAKRORI** shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 27.09.1983 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 031222718 dhe me numër personal I30927086N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

me nënshkrimin e këtij akti dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, personat e sipercituar, themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit bashkëlidhur si Aneksin A, si pjesë integrale dhe thelbësore e këtij Akti Themelimi.

Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet “**Jonian Heaven Group**” Sh.p.k. dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në vijim “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.




Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën *Rruga "Xhoxhi Martini" Vila Nr. 16, Kati I, Ap.2, Tiranë, Shqipëri.*
- 2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale dhe/ose agjencive.

Neni 3-Objekti

- 3.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
 - a) Projektimi, ndertimi, i Resorteve Turistike apo njesive njesive të ndryshme me funksion turizmi, shërbimesh apo banimi,
 - b) Ndertimi i objekteve, banesave kolektive dhe individuale, apartamenteve dhe vilave individuale.
 - c) Projektimi, ndertimi, operimi dhe administrimi i strukturave Portuale ne det apo ne toke, me destinacion turistik apo tregtar;
 - d) Operimi i aktiviteteve te shërbimeve doganore ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
 - e) Venia ne shfrytezim, administrimi, mirembajtja, operimi i Resorteve Turistike, Eklavave te Zhvillimit te Objekteve dhe Fshatrave Turistike dhe njesive te hotelerise, Bareve dhe Restoranteve
 - f) Ofrimi i shërbimeve në fushën e energjise elektrike dhe energjise se rinovueshme. Shërbime në mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të sistemeve te prodhimit, rrjetit të shpërndarjes, transmetimit, etj te energjise elektrike;
 - g) Operimi dhe zhvillimi i aktiviteteve te lojrave te fatit ne perputhje me lejet, licencat autorizimet e nevojshme, si dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi per kete fushe.
 - h) Menaxhimi i pronave te veta dhe apo i pronave te paleve te treta te huaj apo vendas,
 - i) Import-eksport dhe tregtim i artikujve te ndryshem. industriale, mirembajtja, shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyresh, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike
 - j) Shitja, blerja, dhenia apo marrja me qira e pasurive te paluajtshme.
 - k) Transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit. Zhvillimi i udhetimeve turistike dhe shitja e paketave turistike.
 - l) Te kryeje keshillime, trajnime si dhe asistence teknike ne dobi te organizatave, bizneseve ose individeve qe kerkojne asistence te specializuar apo synojne rritjen dhe permiresimin e performances se veprimtarise se tyre;




- m) Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2 Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër, gjithmonë për qëllime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.
- 3.3 Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.4 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
- 3.5 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 4 – Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5 - Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000** (njqind njemije) **LEKË** i cili është i ndarë në 5 (pese) kuota, nga një për secilin ortak të Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:
- 1) **Z. Arben Taipi**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 80.000 Lekë (tetedhjet mije) Lekë, qe përfaqëson **80% (tetedhjetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - 2) **Z. Indrit Bakalli** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;




- 3) **Z. Elton Poga** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 4) **Z. Besnik Myftari** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5) **Z. Artan Lakrori** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve te Shoqerise shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.5 Shoqëria mund të marrë nga Ortakët hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.6 Adresat e Ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse ka pasur më vonë.

Neni 6 –Transferimi i Kuotave

- 6.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 7 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 7 – Administratori/ët

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale (“*ad negotia*”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose Statuti.
- 7.4 Si Administrator i parë është emëruar personi me të dhënat e mëposhtme:



- **Z. INDRIT BAKALLI** shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 02.10.1976 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028471486 dhe me numër personal H61002094F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2(dy) kopje në Shqip.
- 8.2 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.
- 8.3 **Z. Florian Lama**, shtetas shqiptar, i lindur në Tirane në datën 10.10.1981 dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024411816 dhe me numër personal I11010128V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, autorizohet me anë të këtij akti që, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “JONIAN HEAVEN GROUP” Sh.p.k, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe të regjistrojnë Shoqërinë pranë autoriteteve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe çdo dhe të gjitha autoriteteve shqiptare sikurse mund të kërkohet nga ligji i zbatueshëm në fuqi, përfshirë të drejtën për të nënshkruar aktet dhe dokumentet përkatëse në këto organe.

* * *

Z. ARBEN TAIPI

Arben Taip

Z. BESNIK MYFTARI

Besnik Myftari

Z. INDRIT BAKALLI

INDRIT BAKALLI

Z. ARTAN LAKRORI

Artan Lakrori

Z. ELTON POGA

Elton Poga

ANEKSI A

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “JONIAN HEAVEN GROUP” Sh.p.k.

KAPITULLI I EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet “Jonian Heaven Group” Sh.p.k. dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar (në vijim “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën *Rruga "Xhoxhi Martini" Vila Nr. 16, Kati I, Ap.2 Tiranë, Shqipëri.*
- 2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale dhe/ose agjencive.

Neni 3-Objekti

- 3.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
 - a) Projektimi, ndertimi, i Resorteve Turistike apo njesive njesive të ndryshme me funksion turizmi, shërbimesh apo banimi,
 - b) Ndertimi i objekteve, banesave kolektive dhe individuale, apartamenteve dhe vilave individuale.
 - c) Projektimi, ndertimi, operimi dhe administrimi i strukturave Portuale ne det apo ne toke, me destinacion turistik apo tregtar;
 - d) Operimi i aktiviteteve te shërbimeve doganore ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
 - e) Venia ne shfrytezim, administrimi, mirembajtja, operimi i Resorteve Turistike, Eklavave te Zhvillimit te Objekteve dhe Fshatrave Turistike dhe njesive te hotelerise, Bareve dhe Restoranteve



- f) Ofrimi i shërbimeve në fushën e energjise elektrike dhe energjise se rinovueshme. Shërbime në mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të sistemeve të prodhimit, rrjetit të shpërndarjes, transmetimit, etj të energjise elektrike;
 - g) Operimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të lojrave të fatit në perputhje me lejet, licencat autorizimet e nevojshme, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për këtë fushë.
 - h) Menaxhimi i pronave të veta dhe apo i pronave të paleve të treta të huaj apo vendas,
 - i) Import-eksport dhe tregtim i artikujve të ndryshëm. industriale, mirembajtja, shitja me shumicë e pakicë e pajisjeve elektrike, elektronike, lende të pare për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zyresh, kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike
 - j) Shitja, blerja, dhënia apo marrja me qira e pasurive të paluajtshme.
 - k) Transport i mallrave dhe udhëtareve brenda dhe jashtë vendit. Zhvillimi i udhëtimeve turistike dhe shitja e paketave turistike.
 - l) Të kryejë keshillime, trajnime si dhe asistencë teknike në dobi të organizatave, bizneseve ose individëve që kërkojnë asistencë të specializuar apo synojnë rritjen dhe përmirësimin e performancës së veprimtarisë së tyre;
 - m) Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie në ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.6 Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër, gjithmonë për qëllime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.
- 3.7 Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.8 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
- 3.9 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 4 – Kohëzgjatja e Shoqërisë


- 4.1 Shoqëria themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI II
KAPITALI, KONTRIBUTET,
NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Neni 5 – Kapitali dhe Kuotat

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000** (njqind njemije) **LEKË** i cili është i ndarë në 5 (pese) kuota, nga një për secilin ortak të Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:
- 1) **Z. Arben Taipi**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 80.000 Lekë (tetedhjet mije) Lekë, qe përfaqëson **80% (tetedhjetë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - 2) **Z. Indrit Bakalli** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - 3) **Z. Elton Poga** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - 4) **Z. Besnik Myftari** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - 5) **Z. Artan Lakrori** zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 5.000 Lekë (pese mije) Lekë, qe përfaqëson **5% (pese përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve të Shoqërisë shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.5 Shoqëria mund të marrë nga Ortakët hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.6 Adresat e Ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse ka pasur më vonë.



Neni 6 – Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë, kurdo dhe për më shumë se një herë, përmes kontributit në para apo në natyrë apo me kredi, në zbatim të dispozitave ligjore.
- 6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryher në momentin kur kuotat e emetuara dhe të nënshkruara më parë janë shlyer tërësisht.
- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 6.4 Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i Kuotave

- 7.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirish të transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 7.2 Me përjashtim të rastit kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe, Ortakët nuk mund të vënë peng, barrë siguroese ose çfarëdolloj barre tjetër mbi kuotat e Shoqërisë dhe as mbi asetet e saj që fitohen gjatë Kohëzgjatjes së Shoqërisë me qëllim të realizimit të Projektit të lartpërmendur .
- 7.3 Me përjashtim të rastit kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe, nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi kuotat e Shoqërisë nga asnjëri prej Ortakëve tek palët e treta nëpërmjet (i) një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, (ii) një akti shkëmbimi (ex neni 757 i Kodit Civil), (iii) një kontributi në Shoqëri të treta ose (iv) çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpërsëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë së ortakëve të Shoqërisë tek të tretët.
- 7.4 Kuotat e Shoqërisë janë të transferueshme inter vivos, kundrejt pageses, sipas procedurës së përcaktuar nga paragrafët në vijim të këtij neni, duke konsideruar ndalimin/përjashtimin nga transferimi sipas pikës 7.2 më sipër.
- 7.5 Ortaku që synon të transferojë të drejtën e pronësisë mbi kuotën që zotëron (në vijim "**Ortaku Shitës**"), duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim të gjithë Ortakët e tjerë (në vijim "**Ortakët e Tjerë**") nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrjeje (në vijim "**Njoftimi**") të dërguar në adresën përkatëse të Ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë çmimin e kalimit të kuotës.
- 7.6 Ortakët e Tjerë do të kenë të drejtë të blejnë kuotën e ofruar, me të njëjtin çmim sikurse të përcaktuar në Njoftim dhe në asnjë rast, përveçse kur pala përkatëse bie

dakord në formë të shkruar, palës së tretë nuk do t'i ofrohen kushte më të favorshme shitje në krahasim me ato që i ofrohen ortakëve të tjerë të Shoqërisë. Nëse cilido prej Ortakëve të Tjerë synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, duhet të njoftojë Ortakun Shitës me letër rekomande me njoftim marrjeje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit. Në të kundërt, do të konsiderohet se është hequr dorë prej së drejtës së parablerjes.


- 7.7 Nëse më shumë se një prej Ortakëve të Tjerë ka ushtruar të drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të blihen prej tyre në përpjesëtim me kuotat përkatëse që ata zotërojnë në Shoqëri me te njëjtat kushte dhe afate të propozuar nga i treti, Ortaku Shitës.
- 7.8 Nëse asnjë prej Ortakët të Tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të sipërshtuar, Ortaku Shitës do të jetë i lirë të shesë/transferojë tek i treti kuotën e përcaktuar në Njoftim, i cili duhet të përmbajë: (i) emrin e të tretit blerës, (ii) çmimin për transferimin e kuotës. Transferimi i kuotës së zotëruar nga ortaku do të kryhet vetëm pas miratimit unanimit nga Asambleja të çmimit të shitjes dhe i palës blerëse, i cili nuk duhet të jetë më i ulët nga ai i përcaktuar në nenin 7.4. Miratimi nga Asambleja nuk do të vonohet apo pengohet pa shkaqe të arsyeshme, të cilat mund të lidhen vetëm me rregullsinë e transaksionit.
- 7.9 Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një Ortak tek një Shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij Ortaku ose kontrollon këtë ortak ose në rast transferimi nga një Ortak tek një pasardhës ose paraardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkëshorti, nëse është dhënë pëlqimi me shkrim nga të gjithë Ortakët e shoqërisë. Në këtë Statut, fjala “kontroll” ka të njëjtin kuptim të përdorur në ligjin tregtar.

KAPITULLI III ASAMBLEJA E ORTAKËVE, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Neni 8 – Asambleja e Përgjithshme, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 8.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjesë të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe të japë votën, për aq sa ç'është përqindja e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, edhe jo ortak, i pajisur me një prokurë të thjeshtë, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble ortakësh, dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë.


- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjesë të tyre.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që Asambleja e Përgjithshme të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të quhet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.
- 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit financiar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mbledhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë hedhjen dhe nënshkrimin e verbalit mbi librin përkatës.
- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, të lidhur me video/telekonferencë nën kujdesin e Shoqërisë, ku ortakët do të mund të mbledhen.



- 8.12 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i emëruar nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e kërkuar nga kuadri ligjore ligjore në fuqi, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.
- 8.13 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e Përgjithshme dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshëmrisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe cdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

Neni 9 –Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- zmahimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - ndryshimi i statutit të Shoqërisë;
 - transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
 - pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anulimin e tyre;
 - përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planin strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
 - miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;
 - miratimin e pasyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
 - miratimin e shpërndarjes e fitimeve vjetore;
 - miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm të Shoqërisë të hartuar nga Departamenti i Auditit në varësi të Ortakut të Vetëm;
 - emërimin dhe shkarkimin e Administratorit dhe Drejtuesit/Menaxhët e lartë të Shoqërisë, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendimit;
 - miratimin e themelimit të shoqërive të reja të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
 - miratimin e krijimit të Joint Ventures dhe bashkëpunimeve të cilit do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;



- o. blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
 - p. miratimin e kërkesave të reja dhe vendosjen për rinovim të kërkesave ekzistuese për financim;
 - q. vendosjen e barrëveve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
 - r. dhënien e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
 - s. shitjen e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
 - t. shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në lidhje me to, duke përjashtuar këtu shitjet e njësive/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit tek klientët e interesuar sipas një plan biznesi të miratuar përkatësisht për çdo projekt imobiliar;
 - u. akordimin e huave ose paradhënieve për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherve e lartë për nevoja personale;
 - v. miratimi i blerjeve, shitjeve, nënshkrimi i kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër për një vlerë mbi 100.000 EUR (një qind mijë Euro);
 - w. investimet (CAPEX) e paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqëris, mbi një vlerë 50.000 EUR (pesëdhjetë mijë Euro);
 - x. shpenzimet (OPEX) e paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë mbi një vlerë 20.000 EUR (njëzet mijë Euro);
 - y. miratimin e rregullores/ve së brendshme të Shoqërisë;
 - z. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme thirret dhe mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 9.3 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën të kuorumit të ortakeve, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërish brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.

Neni 10 – Administratori/ët

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Për më shumë qartësi,

Administratori/ët përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, ka të drejtë të:

- a. kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 100.000 EUR (njëqind mijë Euro);
 - c. kryejë investimet (CAPEX) e parashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë deri në një vlerë të barabartë me 50.000 EUR (pesëdhjetë mijë Euro), , për çdo trasaksion apo në agregat, mbi këtë vlerë do të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë;
 - d. kryejë shpenzimet (OPEX) e parashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë deri në një vlerë të barabartë me 20.000 EUR (njëzet mijë Euro), për çdo trasaksion apo në agregat, mbi këtë vlerë do të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë;
 - d. hartojë procedurat e brendshme, urdhërat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.
- 10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale (“ad negotia”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.

Neni 11 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 11.1 Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t’i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 12– Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 12.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së Përgjithshme.



- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 13 – Fitimet

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, pasi janë zbritur të gjitha shumat që Asambleja ka vendosur të vërë mënjanë, i shpërndahen Përgjithshme proporcionalisht me kuotat në kapitalin e Shoqërisë që ata kanë respektivisht.
- 13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve – tërësisht apo pjesërisht – në vitet ushtrimore pasardhës.


KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 14 – Shpërndarja

- 14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për modifikimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast paafësie, vdekjeje apo falimentimi të ortakëve.

Neni 15 – Likuidimi

- 15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim
- 15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitet të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit, si dhe në lidhje me riinvestimin eventual në Biznes Social të të ardhurave që i shpërndahen aksionarëve pas likuidimit, nga investimet e tyre në kapitalin e shoqërisë, duke përcaktuar edhe modalitetet e nevojshme për riinvestimin.
- 15.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.



**KAPITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 16 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave Statutore, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje midis palëve të interesuara. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët do të mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 17 – Dispozitat ligjore në fuqi

- 17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.


Tirane, më datë 30 Janar 2019

**ORTAKËT NËNSHKRUES
TË
AKTIT TË THEMELIMIT DHE TË STATUTIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
“JONIAN HEAVEN GROUP” SH.P.K**


Z. ARBEN TAIPI

Arben Taipi



Z. BESNIK MYFTARI

Besnik Myftari


Z. INDRIT BAKALLI

INDRIT BAKALLI


Z. ARTAN LAKRORI

Artan Lakrori


Z. ELTON POGA

Elton Poga
